



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_, Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, regjistruar me numër rendor 2, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 1249 Prot., datë 13.02.2023, referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Në funksion të kompetencave që Këshilli i Lartë Gjyqësor është i ngarkuar sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si një strukturë e re kushtetuese, administron të dhëna statistikore për sistemin gjyqësor nga momenti i krijimit të saj, pra nga viti 2018 e në vijim.

Konkretisht, Këshilli mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore sipas vendimeve të miratuara prej saj, vendimi nr. 25, datë 07.02.2019 “Mbi informacionin periodik të kryetarëve të gjykatave në lidhje me veprimtarinë gjyqësore” dhe vendimi nr. 47, datë 11.02.2021 “Për miratimin e “Udhëzuesi “Për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efikasitetit të gjykatave””, të cilat përmbajnë të dhëna në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjykatave, kohëzgjatjen e çështjeve dhe aspekte të tjera të administrimit gjyqësor, me qëllim përmirësimin e produktivitetit të gjykatave ose uljen e ngarkesës së gjyqtarëve dhe të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Në zbatim të vendimit nr. 47 datë 11.02.2021 të KLGJ-së, raportohen nga gjykatat statistika vjetore mbi çështje familjare në tërësi dhe nuk klasifikohen sipas natyrës specifike të tyre sikurse kërkohet nga ana juaj.

Sa më sipër KLGJ-ja, gjendet në pamundësi për të dhënë informacionin e kërkuar. Ju mund t'i drejtoheni Ministrisë së Drejtësisë për informacione të nevojshme, autoritet i cili ka administruar të dhënat statikore të gjykatave përpara krijimit të Këshillit si dhe institucioni kompetent për përpunimin e statistikave vjetore për çështjet gjyqësore.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!